

VËSHTRIM MBI TREGJET

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2016
- Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 qershor 2016
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 qershor 2016

ZHVILLIME TË TJERA

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë
- *Workshop* mbi “Forcimin e Kontabilitetit dhe Auditimit për Mbikëqyrje të Stimuluar”
- Mbledhja e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës (ERC) anëtare të organizatës IOSCO
- Dita e Ndërgjegjësimit për Pensionet në Shkup, Maqedoni
- AMF organizon inspektim të përbashkët me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA) në Maqedoni
- Zhvillohet Konferenca e 7-të Ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet

EDUKIMI I KONSUMATORIT

- Mbrojtja e Konsumatorit në Bashkimin Evropian (pjesa e tretë)

LAJME NDËRKOMBËTARE

- | | | |
|------------------------|---------|------------------|
| ○ Bosnje – Hercegovina | ○ Greqi | ○ Republika Çeke |
| ○ Rumani | ○ Turqi | |

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-gusht 2016 kapën vlerën mbi 9.38 miliardë lekë, ose 4.56% më shumë se gjatë periudhës janar-gusht 2015. Gjatë periudhës janar-gusht 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 711,281 me një ulje prej 1.05% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 36.37% në krahasim me periudhën janar-gusht 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 1.69 miliardë lekë, apo 63.80% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 5.08% gjatë periudhës janar-gusht 2016, krahasuar kjo me periudhën janar-gusht 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 5.76 miliardë lekë gjatë periudhës janar-gusht 2016, duke shënuar një rritje prej 7.14% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 61.60% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësi të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 13.38% të tregut të Jo-Jetës;
- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 14.10 % të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 5.12% krahasuar me periudhën janar-gusht të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori”, i cili përbën 56.59% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 5.76 miliardë lekë gjatë periudhës janar-gusht 2016, duke shënuar një rritje prej 7.14% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30 qershor 2016

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.06.2016 tregon një total asetesh neto prej 1,112.20 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 183.45 milionë lekë (19.75%) krahasuar me fundin e vitit 2015.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.06.2016 tregon një total asetesh neto prej 1,112.20 milionë lekë dhe me një rritje prej afro 183.45 milionë lekë (19.75%) krahasuar me fundin e vitit 2015. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 8.10 milionë euro*.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.06.2016 ishte 14,840 anëtarë duke shënuar rritje prej 18.16% krahasuar me fundin e vitit 2015.

Tregues të Fondeve të Pensioneve


Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (në %)
Periudha janar-qershor	31.12.'15	30.06.'16	31.12.'15-30.06.'16
Asetet neto të FP	928.74	1,112.20	19.75

* Kursi zyrtar i këmbimit ("fiksi") më 30.06.2016 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 137.33 lekë.


Asetet neto dhe numri i anëtarëve sipas fondeve të pensioneve

Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL	5,665	556.00
RAIFFEISEN	2,640	370.89
SiCRED PENSION	6,535	185.31
TOTAL	14,840	1,112.20

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve në fondet e pensioneve, 30.06.2016 (në %)



Ndarja e tregut sipas vlerës së aseteve neto të fondeve të pensioneve, 30.06.2016 (në %)



Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30 qershor 2016

Gjatë periudhës janar-qershor 2016, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre dy fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj” dhe Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro”.

* Me Vendim të Bordit të AMF-së nr. 85, datë 30.05.2016 është licencuar shoqëria “Credins Invest - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Aseteve të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. sh.a.” Informacioni për aktivitetin e Credins Invest do të pasqyrohen në publikimet e ardhshme.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.06.2016, vlera neto e aseteve të fondeve, arriti mbi 71.76 miliardë lekë me një rritje prej 7.12%, krahasuar me 31.12.2015.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 64.06% të aseteve të fondeve, me një ulje prej 2.52% krahasuar me 31.12.2015.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në fondet e investimit më 30.06.2016 është 32,435.

ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë

Në vazhdim të raportimit në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë të datës 18 korrik 2016, mbi veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2015, me datë 21 shtator 2016 u zhvillua seanca e dytë e raportimit në lidhje me pyetjet e bëra nga anëtarët e këtij Komisioni.

Autoriteti u përfaqësua nga Znj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Z. Pajtim Melani, Kryetar i Bordit të AMF-së, si edhe drejtues të tjerë të lartë të Autoritetit. Përfaqësuesit e Autoritetit iu përgjigjën të gjitha pyetjeve dhe çështjeve të ngritura nga relatori, Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe anëtarët e tjerë të këtij Komisioni.

Workshop mbi “Forcimin e Kontabilitetit dhe Auditimit për Mbikëqyrje të Stimuluar”

Në datat 7–9 shtator 2016 në Vjenë, Austri u zhvillua *workshop-i* “Forcimi i Kontabilitetit dhe Auditimit për Mbikëqyrje të Stimuluar” (*Leveraging Accounting and Auditing for Enhanced Supervision*). *Workshop-i* kishte në fokus përqasjen e rregullatorëve me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për një mbikëqyrje të tregjeve financiare sa më të plotë dhe efikase. *Workshop-i* u organizua nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën në Raportimin Financiar dhe kishte si qëllim njohjen e thelluar të standardeve IFRS dhe ndryshimeve të pritshme. Në *workshop* u pasqyruan diferencat që karakterizojnë këto standarde me kërkesat rregullatore, duke synuar sa më shumë përafrimin e tyre.

Workshop-i kishte në fokus përqasjen e rregullatorëve me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për një mbikëqyrje të tregjeve financiare sa më të plotë dhe efikase.

Workshop-i u nda në tre etapa:

- Gjatë etapës së parë u trajtua nevoja për përafrim dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Auditorëve dhe Supervizorëve duke përfutur nga ekspertiza e njëri-tjetrit, për qëllim e përbashkët të rritjes së cilësisë së mbikëqyrjes;
- Gjatë etapës së dytë u fol për disa nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, IFRS 7, IFRS 8, IFRS 9 dhe IFRS 15; për zbatimin e tyre duke sjellë eksperiencën nga vende të ndryshme si: Maqedonia, Gjeorgjia, Ukraina dhe sfidat në zbatimin e tyre praktik në përgjithësi;
- Gjatë etapës së tretë u bë njohja me IFRS 16 dhe IFRS 4 që lidhen me kontratat e sigurimit, si dhe për diferencat midis qasjeve sipas standardeve të IFRS kundrejt atyre sipas *Solvency II*.

Temat e mësipërme u prezantuan nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare si: Banka Botërore, Bordi Ndërkombëtar i Auditimit dhe Standardeve të Sigurimit, (*International Auditing and Assurance Standards Board, IAASB*), Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Autoriteti Evropian i Bankave (EBA), Banka Qendrore Evropiane (ECB); Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i Austrisë (FMA), Banka Kombëtare e Holandës, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), Banka Qendrore e Ukrainës, Banka Kombëtare e Gjeorgjisë, Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë, etj.

Mbledhja e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës anëtare të organizatës IOSCO

Në datën 13 shtator 2016, në Pragë, Çeki, u zhvillua mbledhja e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës (ERC), në kuadrin e komiteteve të Organizatës Ndërkombëtare të Letrave me Vlerë (IOSCO). Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si anëtar me të drejta të plota i këtij Komiteti, u përfaqësua në këtë mbledhje.

Mbledhjet e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës synojnë të ndajnë informacion dhe eksperiencë mes anëtarëve të këtij Komiteti, me qëllim rritjen e kapaciteteve rregullatore dhe vendosjen e standardeve në procesin mbikëqyrës.

Mbledhja e 13 shtatorit e përqendroi vëmendjen në dy çështje kryesore:

- Puna e bërë nga grupet e ngritura në kuadër të IOSCO-s;
- Zhvillimet rregullatore në vendet anëtare të ERC.

○○○
Mbledhjet e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës synojnë të ndajnë informacion dhe eksperiencë mes anëtarëve të këtij Komiteti, me qëllim rritjen e kapaciteteve rregullatore dhe vendosjen e standardeve në procesin mbikëqyrës.

○○○

○ ○ ○
Një numër ankesash
vijnë në lidhje
me aktivitetet e
palicencuara dhe
ilegale, duke përbërë
një shqetësim për
rregullatorët e këtyre
vendeve, pasi kjo
zvogëlon, minon
besimin tek tregjet dhe
aftësinë e rregullatorit
për të mbrojtur
investitorët individualë.

○ ○ ○

Në lidhje me çështjen e parë u prezantua:

- Puna e bërë nga Grupi i Punës mbi problemet e menaxhimit të aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, prezantuar nga përfaqësuesi i rregullatorit irlandez, ku u vu theksi në stabilizimin e risqeve që lidhen me këtë fushë, sidomos për efektin që kanë në riskun sistematik. Fushat për stabilizimin e riskut janë: menaxhimi i riskut të likuiditetit dhe të riskut operacional, monitorimi i aktiviteteve të dhënies hua të titujve dhe probleme të levës financiare;
- Puna e bërë nga Task Force mbi sjelljet në treg të subjekteve, prezantuar nga Sekretari i Përgjithshëm i IOSCO-s. Produkti final i Task Force do të jetë krijimi i një pakete të hollësishme rregullatore që do t'i shërbejë rregullatorëve për të luftuar sjelljet jo të drejta të subjekteve në treg me qëllim mbrojtjen e interesave të investitorëve;
- Rezultatet e pyetësorit mbi produktet me levë në tregun me pakicë të OTC (*Over The Counter*) të prezantuar nga përfaqësuesja e rregullatorit francez. Produktet me levë përfaqësojnë: kontratat FOREX që bazohen në luhatjet e kurseve të këmbimit, kontratat për diferencë (CFD) që bazohen në luhatjet e çmimeve të aseteve financiare, si dhe binary options. Ky segment tregu është kompleks dhe me risk të lartë dhe shpesh në dimensionet e aktivitetit *cross-border*, bazuar kryesisht në Internet. Raportet nga tregjet e vendeve të ndryshme kanë treguar se një numër i madh investitorësh kanë pësuar humbje në këto produkte. Gjithashtu, një numër ankesash vijnë në lidhje me aktivitetet e palicencuara dhe ilegale, duke përbërë një shqetësim për rregullatorët e këtyre vendeve, pasi kjo zvogëlon, minon besimin tek tregjet dhe aftësinë e rregullatorit për të mbrojtur investitorët individualë;
- Nevoja për nënshkrimin e marrëveshjes multilaterale të zgjeruar EMMoU (*Enhanced MMoU*). MMoU, e nënshkruar nga pjesa më e madhe e vendeve anëtare të IOSCO-s, ka shërbyer si një mjet për të luftuar praktikën e paligjshme në kushtet e tregjeve të kapitalit *cross-border*. Aktualisht, tregjet e kapitalit po udhëhiqen nga zhvillimet teknologjike, të cilat prezantojnë sfida për rregullatorët. Në këtë mënyrë, nënshkrimi i EMMoU do t'i pajiste anëtarët e IOSCO-s me më shumë fuqi për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ. Përfshirja në procesin e nënshkrimit të EMMoU është një proces që kërkon më shumë sqarime, udhëzime dhe që do të diskutohet në mbledhjet e tjera të rajonit.

Në lidhje me çështjen e dytë:

- Përfaqësuesit e rregullatorit çek prezantuan zhvillimet rregullatore në lidhje me shpërndarjen e instrumenteve financiare. Interes paraqiti eksperiencën mbikëqyrëse ndaj ofruesve të shërbimeve financiare që ofrojnë produkte investimi të papërshtatshme për investitorët individualë, që thyejnë rregullat e biznesit, që ofrojnë informacion të pamjaftueshëm për investitorët, etj. Në procesin mbikëqyrës,

marrëveshjet dypalëshe me rregullatorë të tjerë, apo krijimi i grupeve të përbashkëta të inspektimit kanë dhënë rezultat në eliminimin e mangësive;

- Përfaqësuesi i rregullatorit suedez prezantoi eksperiencën mbi mbrojtjen konsumatore në tregun financiar. Me qëllim sigurimin e mbrojtjes ndaj konsumatorit, autoriteti suedez i ka kushtuar rëndësi miratimit të rregullave që lidhen me sjelljen e biznesit të kompanive financiare ndaj konsumatorit. Këto rregulla përfshijnë parashikime mbi dhënien e informacionit, duke siguruar që klientët e kompanive financiare marrin informacionin e duhur dhe të qartë. Në kuadër të mbrojtjes konsumatore rëndësi merr edukimi i publikut në përgjithësi mbi çështjet financiare.

Gjithashtu, në takimin e datës 13 shtator, përfaqësuesi i ESMA bëri një prezantim mbi punën një vjeçare, duke përmbledhur fakte dhe të dhëna që flasin për rritjen e rolit të Autoritetit Evropian të Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA) në mbrojtjen e investitorëve dhe promovimin e tregjeve financiare të rregulluar dhe të qëndrueshme.

Dita e ndërgjegjësimit për pensionet në Shkup, Maqedoni

Agjencioni për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional i Republikës së Maqedonisë (MAPAS) organizoi më 15 shtator 2016, në Shkup, Maqedoni aktivitetin “Dita e ndërgjegjësimit për pensionet”. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte promovimi i rëndësisë së kursimit për të ardhmen, me qëllim shmangien e varfërisë dhe ruajtjen e standardeve të jetesës pas daljes në pension. Përballë sfidave, me të cilat përballen sistemet e pensionit të shumicës së vendeve në rajon, skemat private të pensionit marrin një rëndësi të veçantë, për të plotësuar të ardhurat, që i siguron pensionistit skema shtetërore e pensionit. Në këto rrethana aktiviteti synoi në përcjelljen e mesazhit, që individët duhet të ndryshojnë mënyrën e të menduarit në çështjet që lidhen me planifikimin dhe investimin për pension dhe të rritet ndërgjegjësimi i tyre në këtë drejtim.

Aktiviteti ishte organizuar në dy pjesë kryesore. Gjatë pjesës së parë, personalitete të Republikës së Maqedonisë prezantuan rëndësinë e aktivitetit dhe të skemave private të pensionit për individët. Z. Bulent Dervisi, Kryetar i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, prezantoi veprimtarinë e MAPAS, si dhe disa statistika mbi shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit të pensioneve private në Republikën e Maqedonisë. Guvernatori i Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë, Z. Dimitar Bogov, në prezantimin e tij theksoi rëndësinë e fondeve private të pensionit. Pas këtyre prezantimeve, pjesën e dytë të aktivitetit e zuri paneli i diskutimit me moderator Prof. Tome Nenovski, anëtar i Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it. Në panel morën pjesë përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Kroacisë (HANFA), si dhe

Përballë sfidave, me të cilat përballen sistemet e pensionit të shumicës së vendeve në rajon, skemat private të pensionit marrin një rëndësi të veçantë, për të plotësuar të ardhurat, që i siguron pensionistit skema shtetërore e pensionit.

Inspektimi i INSIG në Maqedoni është me interes nga pikëpamja e tregut shqiptar të sigurimeve dhe sidomos të Grupit të Sigurimit EUROSIG.

përfaqësues nga Banka Kombëtare e Sllovakisë. Tema e përgjithshme e panelit ishte: “Informimi dhe edukimi i publikut mbi fondet private të pensionit: Sfidat dhe eksperiencat në vendet e tjera”. Synimi i panelit ishte këmbimi i përvojave për informimin e publikut në vendet e tjera. Të gjithë pjesëmarrësit në panel prezantuan karakteristikat e sistemit të pensioneve në vendet e tyre, si dhe sfidat me të cilat përballen këto sisteme. Ata prezantuan edhe eksperiencat, praktikat, aktivitetet dhe projektet e ndërmarra në lidhje me çështjen e rritjes së ndërgjegjësimit të publikut dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në skemat private të pensionit. Në përfundim të prezantimeve, të pranishmit në aktivitet drejtuan pyetje ndaj pjesëmarrësve në panel, të cilat kryesisht konsistojnë në nxitjet fiskale të skemave private të pensionit në vendet e tyre, punën e bërë nga autoritetet mbikëqyrëse mbi transparencën e skemave private të pensionit apo efektet e projekteve të ndërmarra në rritjen e numrit të anëtarëve në fondet private të pensionit.

AMF organizon inspektimin të përbashkët me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni

AMF në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA) në Maqedoni zhvilluan në datat 19-23 shtator 2016 një inspektim të përbashkët pranë shoqërisë INSIG Maqedoni, si filial i shoqërisë INSIG sh.a. Shqipëri. Ekipi që mori pjesë në inspektim nga AMF përbëhej nga specialistë të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve dhe aktuarë. Pjesëmarrës në inspektim dhe në takimet me përfaqësuesit e ISA-së ishin edhe Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare të AMF-së. Grupi i inspektimit i autoritetit maqedonas të sigurimeve, ISA, e vazhdoi inspektimin në vend pranë shoqërisë INSIG Maqedoni edhe përgjatë një jave tjetër.

Inspektimi i INSIG në Maqedoni është me interes nga pikëpamja e tregut shqiptar të sigurimeve dhe sidomos të Grupit të Sigurimit EUROSIG. Gjithashtu ky inspektim i përbashkët shërbeu edhe si një shkëmbim eksperience midis dy vendeve.

Zhvillohet Konferenca e 7-të Ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet

Në datat 19-21 shtator u zhvillua Konferenca e 7-të Ndërkombëtare mbi Pensionet dhe Kursimet. (*7th Global Pension and Savings Conference*). Konferenca zhvillohet çdo 2 vjet dhe organizohet nga Banka Botërore në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS). Konferenca u fokusua në mësimet e eksperiencat e nxjerra në zbatimin e politikave në sistemin e pensioneve në këto 20 vitet e fundit. Pjesëmarrës në konferencë ishin ekspertë, akademikë,

mbikëqyrës dhe rregullatorë të sistemit të mbikëqyrjes së pensioneve, të cilët diskutuan mbi informacionet dhe sfidat me të cilat përballet industria e pensioneve dhe kursimeve në rajone të ndryshme. Të pranishëm në konferencë ishin edhe zyrtarë të lartë të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Konferenca kishte disa sesione të ndara sipas tematikave:

- Sesiioni 1: Komunikimi dhe pasqyrimi i reformave - në këtë seksion u diskutua mbi reformat dhe eksperiencat në disa vende dhe mësimet që mund të nxirren nga këto eksperiencia;
- Sesiioni 2: Kalimi nga kursimet afatshkurtra në të ardhura për pensionet;
- Sesiioni 3: Ndërtimi i iniciativave për përfshirjen financiare për të zgjeruar sistemin e pensioneve - në këtë sesion u diskutua se si përmirësimi në sistemet e përfshirjes financiare mund të shërbejë për të zgjeruar mbulimin dhe reduktuar kostot në sistemin e pensioneve. Në prezantime u theksua se zhvillimet e reja kanë krijuar mundësi për të tejkaluar barrierat e shpërndarjes dhe kostot që kanë qenë një problem për zgjerimin e mëtejshëm;
- Sesiioni 4: Bindje dhe detyrim? - Hartuesit e politikave të pensioneve duhet të gjejnë balancën e duhur midis bërjes së pensioneve të detyrueshme, përdorimit të teknikave dhe mënyrave të reja për të marrë rezultatet më të mira kur pjesëmarrja dhe kontributet janë vullnetare;
- Sesiioni 5: Arti i bindjes dhe politikat e reformës së pensioneve - në këtë sesion u diskutua për politikat ekonomike, si mund të komunikohen ato në mënyrë të suksesshme dhe si të zbatohen reformat e pensionit në mënyrë komplekse duke konsideruar si eksperiencat akademike ashtu edhe ato praktike;
- Sesiioni 6: Investimi në pensione si mënyrë zhvillimi;
- Sesiioni 7: Investimi në pensione për rezultate afatgjata;
- Sesiioni 8: Pensionet dhe plakja e popullsisë – në seksion u pasqyrua një studim evropian, i cili ka vëzhguar qëndrimin ndaj plakjes, daljes në pension dhe kursimeve;
- Sesiioni 9: Si do të jetë sistemi i pensioneve në viti 2066. Çfarë do të ketë sistemi i pensioneve pas 50 vitesh;
- Sesiioni 10: Strategjia dhe mbikëqyrja e fondeve të pensionit. – Sesiioni shqyrtoi një numër çështjesh në mbikëqyrjen aktuale të pensioneve dhe si të sigurohet fokusi tek mbikëqyrja dhe rezultatet afatgjata;
- Sesiioni 11: Administrimi i skemave të pensioneve.

Programi i konferencës përfshinte diskutime lidhur me mjetet, teknikat dhe politikat të cilat synojnë përmirësimin e rezultateve të pensioneve në dekadat e ardhshme. Konferenca dha një kontribut të rëndësishëm për platforma dhe politika sa më efikase për mënyrën e shpërndarjes së pensioneve publike dhe private, që të mund të ndihmojë për të zhdukur varfërinë dhe për të rritur prosperitetin e përbashkët.

Programi i konferencës përfshinte diskutime lidhur me mjetet, teknikat dhe politikat të cilat synojnë përmirësimin e rezultateve të pensioneve në dekadat e ardhshme.

Mbrojtja e konsumatorit në Bashkimin Evropian

(pjesa e tretë)

Politikat e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e konsumatorit përfshijnë ndër të tjera kompetencat e Bashkimit Evropian, bazën ligjore dhe përcaktimin e nocionit të konsumatorit. Një analizë në thellësi e kryer nga Shërbimi Kërkimor i Parlamentit Evropian jep një pasqyrim të politikave për mbrojtjen e konsumatorëve duke u fokusuar në parimet e përgjithshme. Korpusi legjislativ konsiston në 90 direktiva dhe disa rregullime të tjera. Krahës tyre Bashkimi Evropian ka edhe mekanizma të tjerë për të monitoruar dhe përmirësuar mbrojtjen e konsumatorit, studimin e tregut, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, fushatat promovuese, etj.

Dokumenti më poshtë është marrë me shkurtime nga faqja zyrtare online e Parlamentit Evropian [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2015/565904/EPRS_IDA\(2015\)565904_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2015/565904/EPRS_IDA(2015)565904_EN.pdf)



Vështirësia e përkufizimit të termit “prosumer” shtrihet në emrin e tij hibrid, duke kombinuar “konsumatorin”, “prodhuesin” dhe “profesionistin”. Fillimisht, termi është përdorur nga Toffler-i si një mbledhje e “konsumatorit” dhe “prodhuesit”.

Koncepti “Prosumers” (konsumator + prodhues + profesionist)

Në lidhje me ekonominë e ndarë (*share economy*) dhe konceptet e reja të zhvillimit, nocioni “prosumer” kërkon gjithashtu vëmendjen e duhur. Vështirësia e përkufizimit të termit “prosumer” shtrihet në emrin e tij hibrid, duke kombinuar “konsumatorin”, “prodhuesin” dhe “profesionistin”. Fillimisht, termi është përdorur nga Toffler-i si një mbledhje e “konsumatorit” dhe “prodhuesit”. Ndërkohë që prodhimi, konsumi dhe profesionalizmi kanë bashkeekzistuar prej shumë kohësh, zhvillimet teknologjike dhe ligjore e kanë tjetërsuar dhe deri diku e kanë lehtësuar ndërveprimin e tyre, duke e bërë konceptin e ri “prosumer” një realitet. Përse ky koncept shmanget në mënyrë të qartë përkufizimin ligjor? Një person që operon në një fushë jashtë kompetencës profesionale, aftësive dhe njohurive të tij, është trajtuar si konsumator. Dhe në qoftë se një “prosumer” është prodhues dhe konsumator në të njëjtën kohë, vija e hollë midis tyre mund të krijojë paqartësi ligjore në lidhje me përgjegjësinë (e një konsumatori në kuptimin e një pale jo-profesioniste dhe një biznesi ose më mirë, një sipërmarrësi).

Në një situatë ku natyra ekuivalente ligjore e një “prosumer”-i ka nevojë të sqarohet nga gjykatat, qarkullimi, shuma e produkteve, shpeshësia ose koha e përfshirë në një aktivitet të një “prosumer”-i, ndihmon për të përcaktuar se në çfarë cilësie vepron një person (së bashku me të drejtat dhe detyrimet përkatëse), duke mbajtur parasysh se ka një nivel të lartë të interpretimit të fakteve dhe rrjedhimisht të shqyrtimeve gjyqësore.

Mundësitë tregtare që Interneti u ofron aktualisht përdoruesve të tij ndikojnë fuqishëm në modelet e konsumit dhe të prodhimit dhe, pikërisht për shkak të natyrës hibride të termit, ligjvënësit kanë qenë të ngadaltë për t’u përgjigjur. Dy argumente të rëndësishme duhet të konsiderohen



Konsumatori përfundimtar në “prosumer” rrjedhimisht kërkon mbrojtjen e duhur, por njësoj vepron edhe prodhuesi në “prosumer”.

në lidhje me “*prosumers*”. Nga njëra anë, mund të argumentohet që pala më e dobët në argument duhet të mbrohet.

Konsumatori përfundimtar në “*prosumer*” rrjedhimisht kërkon mbrojtjen e duhur, por njësoj vepron edhe prodhuesi në “*prosumer*”. Duket sikur klasifikimi i “*prosumers*” mbetet shumë i debatueshëm, duke pasur parasysh faktin që ai është një koncept kaq i papërcaktueshëm. Disa argumentojnë se një përjasje e drejtë ligjore me këtë lojtar mund të nevojitet të përfshijë një mekanizëm korrigjues, i cili lejon për rregullime pas klasifikimit. Në qoftë se vijnë më shumë raste në gjyq në të ardhmen, do të bëhet më e vështirë të akomodohen “*prosumer*”-at brenda kuadrove aktuale ligjore.

Bosnje – Hercegovina

www.xprimm.com

Vlera totale e primeve të shkruara bruto të realizuar nga siguruesit boshnjakë në gjysmën e parë të vitit 2016 u rrit me 7.86% duke arritur në 316.90 milionë BAM (monedha lokale - *Bosnia and Herzegovina Convertible Mark*) ose rreth 162.03 milionë euro. Këto të dhëna u raportuan nga dy autoritetet e tregut të sigurimeve në Bosnje-Hercegovinë (BiH), NADOS - Agjencia Mbikëqyrëse e Sigurimeve e Federatës së BiH dhe AZORS - Agjencia e Sigurimit të Republikës Serbe (RS). Rreth 71% e totalit primeve të shkruara bruto janë realizuar nga 12 kompanitë e sigurimit të cilat janë të regjistruara në Federatën e BiH (rreth 115 milionë euro), pjesa e mbetur prej 29% (47 milionë euro) është raportuar nga siguruesit e RS.

Primet e shkruara bruto paraqitën një strukturë të tillë ku 19.71% ishte në tregun e sigurimit të Jetës, rreth 32 milionë euro, ndërsa pjesa e tjetër e mbetur prej 80.29% për tregun e sigurimit të Jo-Jetës.

Vlera totale e dëmeve të paguara u ul me rreth 12% në terma vjetore, duke arritur në 61,66 milionë euro, nga të cilat 12 milionë euro janë dëmshpërblime të Jetës. Në tregun e Jo-Jetës, sigurimet motorike llogariten të kenë rreth 77% (38.2 milionë euro) të dëmeve të paguara.

Greqi

www.xprimm.com

Sipas raportimeve të publikuara në faqen *online* të Shoqatës Greke të Kompanive të Sigurimit, HAIC, këto shoqëri sigurimesh, për gjysmën e parë të vitit 2016, raportuan një volum të primeve të shkruara bruto prej 1.88 miliardë euro, ose rreth 5% me pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016 primet e shkruara bruto të Sigurimit të Jo-Jetës përbënin 51% të totalit duke arritur në 967 milionë euro, me rritje prej 0.6%. Sigurimi i Jetës llogaritet të ketë arritur në 922 milionë euro, ose 10% më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Në sigurimet e Jetës, sigurimet me policat tradicionale u rritën me 5.5%, ndërsa produktet e sigurimit të lidhura me skema investimesh raportuan një rritje të ndjeshme prej rreth 43%. Në sigurimet e Jo-Jetës, klasat kryesore raportuan norma negative, kështu MTPL pati zbritje prej 11.5%, Sigurimi Kasko pësoi rënie me 8.2% dhe sigurimi i pronës ra me 5.9%.

Volumi i primeve të shkruara bruto gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2016 për anëtarët e Shoqatës së Sigurimeve Çeke u rrit me 2% duke arritur në CZK 1.2 miliardë, (Korona Çeke) ose rreth 44 milionë euro. Zhvillimi pozitiv i tregut të sigurimeve në gjashtë muajt e parë vazhdon të mbështetet ende te sigurimi i Jo-Jetës, e cila raportoi rritje prej 4.5% të volumit të primeve të shkruara bruto. Ndërsa sigurimi i Jetës që prej dy vitesh ka pasur një rënie, e cila në tremujorin e parë të vitit 2016 ishte me minus 2.2%.

Rumani

www.xprimm.com

Qeveria rumune miratoi së fundmi një ligj që do të sjellë ndryshime thelbësore në kuadrin ligjor të MTPL-së. Ai është ligji i parë i hartuar specifikisht për sektorin e sigurimeve motorike, e cila deri tani qeverisej nga ana e akteve nënligjore të nxjerra nga Autoriteti Rumun i Mbikëqyrjes Financiare.

Ligji u miratua pasi përfaqësuesit e industrisë të transportit protestuan ndaj rritjes së shpejtë çmimeve në më pak se një vit, të cilën siguruesit e shpjeguan si të shkaktuar nga rritja e pretendimeve për pagesat e dëmshpërblimet për dëmtimet fizike, trupore si edhe falimentimin e shoqërive "ASTRA Asigurari" dhe "Karpate ASIG", dy lojtarë të njohur për çmimet e tyre shumë konkurruese në sigurimet MTPL.

Ndryshimet më të rëndësishme që ka sjellë legjislacioni i ri janë:

- Çmimet për të gjitha grupet e konsumatorëve do të mbahen për një periudhë prej 6 muajsh në një nivel referimi i cili do të llogaritet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare deri më 15 tetor;
- Kontratat MTPL do të jenë të vlefshme për periudha që variojnë nga një muaj deri në 12 muaj (edhe shumëfish të periudhës një mujore), në varësi të preferencave të konsumatorëve;
- Siguruesi do të ketë mundësinë të rillogarisë primet nëse të dhënat që jepen nga i siguruari provohen të jenë jo të sakta;
- I siguruari me aftësi për të mbuluar shumën e dëmit që ai i ka shkaktuar një pale të tretë, në mënyrë që të ruaj bonusin e tij pa kërkesa për dëmshpërblime;
- Kontrata MTPL mund të pezullohen përsa kohë automjeti është jashtë përdorimit, ose i është ndaluar të udhëtojë në rrugë. Kjo procedurë do të jetë objekt i rregullimit të mëtejshëm;
- I siguruari është i detyruar të mbulojë shpenzimet për zëvendësimin e automjetit nëse pala e dëmtuar e kërkon atë;
- Siguruesi ka mundësinë e përdorimit të formateve të llogaritjeve telematike për të llogaritur dhe regjistruar historikun e lëvizjes dhe

sjelljes si drejtues automjeti, për konsumatorët. Po kështu, sistemi i bonuseve do të llogaritet duke marrë parasysh jo vetëm historinë e automjetit, por edhe historinë e shoferit, ndryshe nga çfarë ka qenë deri më tani;

- Vlerësuesit e dëmeve do të certifikohen/licencohen nga një organ i specializuar;
- Siguruesit do të përballen me gjoha të larta nëse ata nuk do të respektojnë afatin ligjor për pagesën e një dëmshpërblimi;
- Të siguruarit do të kenë mundësinë të përdorin zgjidhje të drejtpërdrejta me njëri tjetrin, mbi baza vullnetare;
- Dëmtimet trupore do të mund të kompensohen, jashtë sistemit të gjykatave, duke përdorur një tabelë me sistem pikësh për traumat, të llogaritura nga Instituti Rumun i Mjekësisë Ligjore. Në se çështjet kalojnë brenda sistemit ligjor të Gjykatave, ky sistem me pikë nuk do të jetë i zbatueshëm;
- Byroja rumune e Kartanit Jeshil (*Romanian Motor Insurers' Bureau / Romanian Green Card Bureau*) dhe Fondi i Garancisë rumune për mjetet e pasiguruara (*Street Victims' Protection Fund / The Romanian Guarantee Fund for Uninsured Vehicles*) do të bashkohen dhe funksionojnë si një entitet i vetëm.

Ndryshimet e debatuar tani me ato të përshkruara më sipër lidhen me krijimin e një siguruesi shtetëror, i cili mendohet të hyjë në segmentin MTPL.

Turqi

www.xprimm.com

Sipas të dhënave paraprake nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë (TSB), në fund të qershorit 2016, sektori i sigurimeve në Turqi arriti një vlerë totale prej 20.66 miliardë TRY (Lira Turke) ose rreth 6.4 miliardë euro duke shënuar një rritje prej 35.6%. Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 37.83% duke arritur në 18.14 miliardë TRY (rreth 4.27 miliardë euro), ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 19.52%.

Rritja e primeve u nxit më shumë nga rritja në klasat e sigurimit motorik, vlera e primeve të shkruara bruto e të cilave u rrit me 115% duke arritur në 9.58 miliardë TRY (2.89 miliardë euro). Kjo rritje treshifrore e nxitur nga rritja e tarifave të politikave MTPL, ka kontribuar me rreth 32% në volumin e primeve të shkruara bruto. Një vit më parë, kontributi MTPL në tregun turk të sigurimeve ishte rreth 20% në volumin e primeve.

The logo for the Albanian Financial Markets Authority (AMF) features the lowercase letters 'amf' in a dark red color, followed by the word 'ALBANIA' in white uppercase letters. The text is set against a light gray background that is divided into two rectangular sections by a vertical line.

amf ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al